

UDHËZIM
Nr.1, datë 28.1.2009

**PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATËN E KOMPETENCËS PROFESIONALE TË
DREJTUESIT TË VEPRIMTARISË SË OPERATORIT TË TRANSPORTIT RRUGOR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 6 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, pikave 6, 7 dhe 8 të kapitullit II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.325, datë 19.3.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

Neni 1

1. Qëllimi

Udhëzimi përcakton kushtet, që duhet të plotësojë personi fizik (individi), i cili kërkon të pajiset me certifikatën e kompetencës profesionale për drejtues veprimtarie të ndërmarrjes së transportit rrugor, programin e kursit të trajnimit, mënyrën, formën e organizimit të provimit, si dhe përbërjen e komisionit të vlerësimit.

2. Përkufizime

“Certifikatë e kompetencës profesionale”, dokument që provon se personi zotëron njohuri të mjaftueshme juridike, tregtare, financiare dhe teknike për drejtues veprimtarie të ndërmarrjes së transportit rrugor për mallra dhe udhëtarë. Më poshtë e përmendur CKP.

“Drejtues i veprimtarisë së ndërmarrjes së transportit rrugor”, personi fizik i cili drejton efektivisht dhe vazhdimisht veprimtarinë e transportit të ndërmarrjes.

Neni 2

Trajnimi

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor do të shërbejë si qendër për trajnimin dhe testimin profesional të kandidatëve, që dëshirojnë të pajisen me certifikatën e kompetencës profesionale (CKP), për drejtues veprimtarie të ndërmarrjeve të transportit rrugor, duke realizuar kurse të vazhdueshme trajnimi.

2. Programi bazë i kursit të trajnimit profesional të kandidatëve për drejtues veprimtarie të ndërmarrjes së transportit rrugor, respektivisht për transportin rrugor të mallrave dhe transportin rrugor të udhëtarëve kryhet sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

3. Instruktorët e trajnimit duhet të jenë me nivel të lartë kualifikimi, respektivisht, sipas lëndëve përkatëse të programit të trajnimit që mbulojnë, si dhe miratohen nga ministri me propozim të DPSHTRR-së.

4. Programi i kursit të trajnimit organizohet në dy nivele:

a) Niveli i parë i përket njohurive të transportit të brendshëm rrugor:

i) Transporti i mallrave brenda vendit;

ii) Transporti i udhëtarëve brenda vendit.

b) Niveli i dytë, që është nivel më i lartë, i përket njohurive të transportit ndërkombëtar:

i) Transporti ndërkombëtar i mallrave;

ii) Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve.

5. Orët e kursit të trajnimit sipas niveleve ndahen:

a) Për nivelin e parë, që i përket transportit rrugor brenda vendit të mallrave dhe

udhëtarëve, të jetë 96 orë, të ndara në seanca me nga 6 orë secila;

b) Për nivelin e dytë, që i përket transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve, të jetë 120 orë, të ndara në seanca nga 6 orë secila.

6. Kurset e trajnimit organizohen me jo më pak se 10 dhe jo më shumë se 20 pjesëmarrës.

Neni 3 **Provimi**

1. Kandidati i nënshtrohet një provimi të detyrueshëm, me shkrim, të cilin do ta plotësojë me anën e një provimi me gojë për të vendosur nëse ai ka arritur nivelin e kërkuar të njohurive dhe aftësinë praktike të nevojshme për menaxhimin e ndërmarrjes së transportit.

2. Provimi do të kryhet brenda 10 ditëve nga dita e përfundimit të kursit, që ka kryer kandidati.

3. Testet e provimit përgatiten nga instruktorët e qendrës së trajnimit, në bashkëpunim me komisionin e provimit, në përputhje me programin e kursit të trajnimit. Përgatiten jo më pak se katër teste të ndryshme provimi, nga të cilat komisioni përzgjedh testin përfundimtar një ditë para provimit. Testi i përzgjedhur firmoset nga komisioni i provimit, vuloset me vulën e DPSHTRR-së dhe mbyllet në zarf. Zarfi hapet në prani të anëtarëve të komisionit në momentin e fillimit të provimit.

4. Përmbajtja e testeve të provimit me shkrim dhe me gojë, si dhe vlerësimi i tyre.

a) Provimi me shkrim përbëhet nga dy teste:

i) testi i parë:

i-1) për kandidatët që kërkojnë të pajisen me CKP vetëm në transportin brenda vendit, 40 pyetje me zgjedhje të shumëfishta (secila me katër përgjigje të mundshme, vetëm njëra është e saktë), pra gjithsej 40 pikë.

i-2) për kandidatët që kërkojnë të pajisen me CKP në transportin ndërkombëtar për mallra ose udhëtarë, testi, përveç (i-1) më sipër, ka edhe 10 pyetje shtesë me përgjigje direkt, me pesë pikë secila, gjithsej 50 pikë.

ii) testi i dytë i provimit me shkrim përmban 10 ushtrime me shkrim/raste të ndryshme, nga të cilat kandidati zgjedh vetëm pesë prej tyre për t'iu përgjigjur. Secili ushtrim ka dhjetë pikë, gjithsej 50 pikë.

Kohëzgjatja e secilit test është dy orë.

b) Provimi me gojë. Kandidati do të ketë të drejtën e hyrjes në këtë provim vetëm pasi të ketë fituar të paktën 70% të numrit të përgjithshëm të pikëve për secilin test të provimit me shkrim.

5. Në fund të provimit me shkrim komisioni i vlerësimit hedh rezultatet për çdo kandidat në formularin e rezultateve të kandidatit të paraqitur nga instruktorët e trajnimit. Formulari i plotësuar për çdo kandidat firmoset nga komisioni.

Kandidatët që kanë fituar numrin e nevojshëm të pikëve në provimin me shkrim, kalojnë në provimin me gojë. Rezultatet e provimit me gojë pasqyrohen në formularin përkatës të kandidatit.

Komisioni i vlerësimit, brenda tri ditëve nga përfundimi i provimit me gojë, shpall kandidatët fitues.

Neni 4 **Komisioni**

Certifikata e kompetencës profesionale për drejtuesin e veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor lëshohet nga komisioni i vlerësimit të provimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR). Ajo firmoset nga kryetari i komisionit dhe titullari i DPSHTRR-së.

Komisioni përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë, të cilët duhet të kenë mbaruar arsimin e lartë dhe të specializuar në fushat që mbulojnë lëndët e provimit.

Anëtarët janë persona të cilët i cakton ministri sipas listave të dërguara nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë dhe Shoqata e Transportit Rrugor.

Kryetar i komisionit caktohet një person, kontributi i të cilit në fushën e transportit rrugor është i njohur. Ai caktohet me urdhër të ministrit.

Ministria, në fillim të çdo dy vjetëve, i kërkon Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë dhe Shoqatave të Transportit Rrugor emrat e përfaqësuesve, të cilët do të jenë anëtarë të komisionit të vlerësimit.

Komisioni i vlerësimit mbledhet jo më vonë se 10 ditë pas përfundimit të kursit të trajnimit.

Neni 5

Pranimi i kandidatëve

1. Çdo kandidat duhet të plotësojë formularin e identifikimit të kandidatit përpara trajnimit ose përpara provimit për kandidatët të cilët i nënshtrohen vetëm provimit. Formulari duhet të tërhiqet pranë qendrës së trajnimit.

Bashkë me formularin kandidati duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- kërkesë për llojin e CKP që dëshiron;
- fotokopjen e diplomës/dëftesës së noterizuar;
- letërnjoftimin, fotografi me përmasa 4.2x3.5 cm;
- vërtetim banimi.

Kandidatët që vijnë nga rrethet duhet të plotësojnë dosjen pranë Drejtorisë Rajonale të DPSHTRR-së, në bazë qarku.

Arsimi që duhet të ketë kandidati:

a) Kursi i trajnimit për të dy nivelet dhe më pas provimi është i detyrueshëm për të gjithë kandidatët për drejtues veprimtarie të ndërmarrjes së transportit rrugor, që kanë mbaruar shkollën e mesme; ose

b) për ata të cilët kanë mbaruar arsimin e lartë në një degë të caktuar, sipas përcaktimeve të nenit 7 të këtij udhëzimi.

Qendra e trajnimit dhe e testimit

Është përgjegjësi e qendrës:

- të publikojë datat e kursit të trajnimit dhe kryerjes së provimit;

- të mbajë regjistrat e kandidatëve në kurset e trajnimit, provimin me shkrim, provimin me gojë, duke evidentuar rezultatet;

- të mbajë regjistrin e certifikatave të lëshuara dhe të tërhequra;
- të sigurojë që kandidatët të tërheqin certifikatat;
- të ruajë certifikatat deri në shpërndarjen e tyre;
- t'i kërkojë kandidatëve të firmosin për tërheqjen e certifikatave.

Të dhënat që përmban regjistri trajtohen dhe mbikëqyren vetëm nga personat përgjegjës. Fletët e regjistrit firmosen nga personat përgjegjës përkatës.

Publikimi

Qendra e trajnimit dhe e testimit (DPSHTRR) publikon në faqen e saj të internetit datat e kryerjes së kursit të trajnimit dhe zhvillimit të provimit, tarifat përkatëse, informacionin e nevojshëm për kryerjen e kurseve të trajnimit dhe testimit, si dhe pikat e kontaktit (e-mail, tel, fax) për më shumë informacion.

Neni 6

Certifikata e kompetencës profesionale lëshohet në përputhje me modelin A1 dhe

modelin A2 të shtojcës 2, veç për transportin e mallrave dhe veç për transportin e udhëtarëve, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Kandidatët, që kërkojnë të angazhohen brenda të njëjtit nivel si në transportin e mallrave, dhe të udhëtarëve, i nënshtrohen kursit të trajnimit dhe testimit të njohurive të tyre për çështje që lidhen si me transportin e mallrave, dhe me atë të udhëtarëve. Ata do të pajisen me dy certifikata të kompetencës profesionale, përkatësisht, sipas modelit A1 dhe modelit A2.

Kandidatët të cilët kryejnë kurset e trajnimit për CKP në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve apo mallrave, si dhe kalojnë me sukses provimet sipas nenit 3, përfitojnë, respektivisht, kompetencën profesionale për drejtues veprimtarie, edhe për transportin e brendshëm të udhëtarëve apo mallrave.

Certifikata e kompetencës profesionale lëshohet me afat pesëvjeçar.

Neni 7

Përfundimi nga trajnimi e provimi

a) Specialistët e ministrisë, që kanë mbuluar veprimtarinë e politikave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor, hyrjen në treg të ndërmarrjeve të transportit rrugor dhe monitorimin e këtij tregu, dhe që kanë të paktën në këto detyra mbi 3 vjet, përjashtohen nga trajnimi i detyrueshëm dhe provimi për përfitimin e certifikatës së kompetencës profesionale.

b) Përjashtohen nga trajnimi dhe provimi i detyrueshëm, për pjesën që janë diplomuar, të gjithë kandidatët, si inxhinier mekanik, ekonomistë ose juristë.

c) Përjashtohen nga trajnimi, por jo nga provimi, kandidatët, të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme dhe që sigurojnë dëshmi se pesë vitet e fundit kanë drejtuar pa ndërprerje veprimtarinë e një ndërmarrjeje të transportit rrugor.

d) Përjashtohen nga trajnimi dhe provimi me shkrim kandidatët të cilët rinovojnë certifikatën e kompetencës profesionale.

Personat që përfitojnë nga përjashtimi sipas shkronjave “b”, “c” dhe “d” të këtij neni, pajisen me CKP me shënimin e plotë përkatës të përcaktuar në modelin A1 dhe A2 të shtojcës 2.

Neni 8

Kandidatët, të cilët nuk përmbushin pikët e mundshme për t’u kualifikuar në provimin me shkrim, kanë të drejtë të paraqiten deri në dy herë në provimin me shkrim. Në rast të kundërt, ata përsërisin kursin e trajnimit, shoqëruar me detyrimet përkatëse sipas këtij udhëzimi.

Kandidatët, të cilët nuk shpallen fitues në përfundim të provimit me gojë nga komisioni i vlerësimit, kanë të drejtë të paraqiten deri në tri herë në provimin me gojë. Në rast të kundërt, ata përsërisin edhe njëherë kursin e trajnimit, shoqëruar me detyrimet përkatëse sipas këtij udhëzimi.

Neni 9

Zëvendësimi i CKP

Kandidatët mund të kërkojnë zëvendësimin e certifikatës së dëmtuar. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim dhe të shoqërohet me certifikatën origjinale.

Kandidatët mund të kërkojnë zëvendësimin në rast të humbjes së certifikatës. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim dhe të përmbajë sqarime të hollësishme mbi humbjen e saj.

Kandidati mund të kërkojë ndryshim të emrit të tij në certifikatë. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim dhe të shoqërohet me certifikatën origjinale, si dhe me dokumente zyrtare që identifikojnë të njëjtin person.

Certifikata lëshohet vetëm pasi kërkesat si më sipër janë shqyrtuar dhe verifikuar nga komisioni i testimit.

Neni 10
Ankimi

Faza e parë e ankimit përfshin shqyrtimin e ankesës nga komisioni në bazë të rishikimit të pikëve të provimit me shkrim. Komisioni ka të drejtë në ndonjë rast të japë dhe pyetje shtesë. Ankesa bëhet me shkrim dhe shqyrtohet vetëm në rast se ajo bëhet brenda 14 ditëve kalendarike nga rezultati i provimit.

Faza e dytë e ankimit përfshin shqyrtimin e ankesës nga persona të caktuara nga ministri. Ankesa bëhet me shkrim dhe shqyrtohet vetëm në rast se bëhet brenda 14 ditëve kalendarike nga rezultati i fazës së parë.

Neni 11

Ministri, rast pas rasti, me drejtoritë përkatëse në ministri, si dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të interesuara që kanë lidhje me transportin rrugor, ngre grupe pune për kontrollin në plotësimin e kushteve të:

- a) trajnimit të kandidatëve për drejtues veprimtarie në përputhje me programin bazë dhe me këtë udhëzim;
- b) pajisjes me bazën e nevojshme didaktike të qendrës së trajnimit;
- c) organizimit të provimit në përputhje me këtë udhëzim.

Neni 12

Tarifat e pagesave për kurset e trajnimit sipas niveleve, për provimin me shkrim dhe me gojë, për përsëritjen e kurseve të trajnimit dhe provimit, për lëshimin e certifikatës, si dhe për shpërblimin e anëtarëve të komisionit të provimit, caktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrit të Financave.

DPSHTRR-ja i propozon Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, brenda dhjetë ditëve nga dalja e këtij udhëzimi, nivelin e tarifave sipas paragrafit të mësipërm.

Neni 13
Dispozita të përgjithshme

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë masat e duhura për zbatimin e këtij udhëzimi brenda 45 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë masa për përgatitjen e formularit të identifikimit të kandidatit, formularit të rezultateve të kandidatit, regjistrin të kandidatëve, në kurset e trajnimit, në provimin me shkrim, provimin me gojë, regjistrin e certifikatave të lëshuara dhe të tërhequra.

3. Shtojcat 1 dhe 2, bashkëlidhur, janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

LISTA E LËNDËVE

A. Ligji civil

Transporti rrugor i mallrave dhe udhëtarëve

Kandidati duhet, në mënyrë të veçantë:

1. të njihet me tipet kryesore të kontratës së përdorur dhe me të drejtat dhe detyrimet që burojnë prej tyre në transportin rrugor;

2. të jetë i aftë të negociojë një kontratë transporti e vlefshme juridikisht, veçanërisht në lidhje me kushtet e transportimit;

Transporti i mallrave

3. të jetë i aftë të gjykojë një pretendim sipas parimit të tij në lidhje me kompensimin për humbje ose dëmtim të mallrave gjatë transportimit ose për shpërndarjen me vonesë të tyre, dhe të kuptojë se një pretendim i tillë dëmton përgjegjësinë kontraktuale të tij;

4. të njihet me rregullat dhe detyrimet që burojnë nga Konventa CMR mbi kontratën për transportin rrugor të mallrave me rrugë;

Transporti rrugor i udhëtarëve

5. të jetë i aftë të gjykojë një pretendim sipas parimit të tij në lidhje me kompensimin për dëmtimin e udhëtarëve ose dëmtim të bagazheve të tyre të shkaktuar nga një aksident gjatë transportit, ose lidhur me kompensimin për vonesat, dhe të kuptojë sa një pretendim i tillë dëmton përgjegjësinë kontraktuale.

B. Ligji tregtar

Transporti rrugor i mallrave dhe udhëtarëve

Kandidati duhet, në veçanti:

1. të njihet me kushtet dhe formalitetet e vendosura për kryerjen e tregtisë, detyrimet e përgjithshme që bien mbi operatorët e transportit (regjistrimi, mbajtja e informacionit etj.) dhe pasojat e falimentimit;

2. të ketë njohuri për format e ndryshme të shoqërive tregtare dhe rregullat që drejtojnë themelimin dhe operimin e tyre.

C. Ligji social

Transporti rrugor i mallrave dhe mallrave

Kandidati duhet, në veçanti:

1. të njihet me rolin dhe funksionin e institucioneve sociale të ndryshme, të cilat lidhen me transportin rrugor (shoqatat e transportit, kryetarët e shoqatave të transportit, inspektorët e punës etj.);

2. të njihet me detyrimet e sigurimit shoqëror dhe shëndetësor të punonjësve;

3. të njihet me rregullat që drejtojnë kontratat e punës për kategori të ndryshme të punëtorëve të punësuar nga ndërmarrjet e transportit rrugor (formën e kontratës, detyrimet e palëve, kushtet e punës dhe orët e punës, pushimi i paguar, shpërblimi, prishja e kontratës etj.).

D. Ligji fiskal

Transporti rrugor i mallrave dhe udhëtarëve

Kandidati duhet, në mënyrë të veçantë, të njihet me rregullat që drejtojnë:

1. TVSH në shërbimet e transportit;

2. taksat mbi mjetet motorike (taksa e qarkullimit, taksa e mjedisit);

3. taksat “tolls” (për segmente rrugore të veçanta, ura, tunele etj.) dhe taksat e përdorimit të infrastrukturës;

4. taksat mbi të ardhurat.

E. Menaxhimi i biznesit dhe financiar i ndërmarrjes

Transporti rrugor i mallrave dhe udhëtarëve

Kandidati duhet, në veçanti:

1. të njihet me ligjet dhe praktikat në lidhje me përdorimin e çeqeve, faturat e shkëmbimit, dokumentet premtuese për parapagim, kartat e kreditit dhe mjetet dhe metodat e tjera

të pagesës;

2. të njihet me format e ndryshme të kredisë, depozitat e garancisë, borxhet, marrjen në përdorim me këste (leasing), qira etj. dhe me taksat dhe detyrimet që burojnë prej tyre;

3. të dijë çfarë është një bilanc, si është paraqitur ai dhe si interpretohet ai;

4. të jetë i aftë të lexojë dhe interpretojë një llogari fitimi dhe humbje;

5. të jetë i aftë të vlerësojë pozicionin financiar dhe fitimprurës, në mënyrë të veçantë në bazë të raportit financiar;

6. të njihet me elementet e kostos së ndërmarrjes së tij (kostot fikse, kostot variabile, kapitalin e punës, amortizimin, etj.) dhe të jetë i aftë në llogaritjen e kostos për mjet, për kilometër, për udhëtim ose për tonë;

7. të jetë i aftë të hartojë grafikun e organizimit në lidhje me personelin e ndërmarrjes në tërësi dhe të organizojë planet e punës etj;

8. të njihet me parimet e marketingut, publicitetin dhe marrëdhëniet me publikun, përfshirë promovimin e skontove në shërbimet e transportit dhe përgatitjen e dosjeve të klientëve;

9. të njihet me tipet e ndryshme të sigurimit që kanë lidhje me transportin rrugor (detyrimin, dëmin aksidental/ sigurimin e jetës, sigurimin jojetësor dhe bagazheve) me garancitë dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre;

Transporti rrugor i mallrave

10. të jetë i aftë në zbatimin e rregullave që kontrollojnë faturën e shërbimeve të transportit rrugor të mallrave dhe të njohë kuptimin e termave;

11. të njihet me kategoritë e ndryshme, ndihmëse të transportit, rolin e tyre, funksionin e tyre dhe, kur duhet, statusin e tyre;

Transporti rrugor i udhëtarëve

12. të jetë i aftë të zbatojë rregullat që kontrollojnë tarifat dhe çmimin në transportin e udhëtarëve publikë dhe privatë;

13. të jetë i aftë të zbatojë rregullat që kontrollojnë faturën e shërbimeve në transportin rrugor të udhëtarëve.

F. Hyrja në treg

Transporti rrugor i mallrave dhe i udhëtarëve

Kandidati duhet, në veçanti:

1. të njihet me rregullat që drejtojnë veprimtarinë e transportit rrugor për të tretë ose me qira, nënkontraktimin, qiranë e mjetit, dhe në veçanti rregullat që drejtojnë organizimin dhe pranimin në veprimtari, autorizimet për operacionet brenda dhe jashtë vendit, inspektimet dhe sanksionet;

2. të njihet me rregullat për ngritjen e ndërmarrjes së transportit rrugor;

3. të njihet me dokumente të ndryshme të kërkuara për operimin në shërbimet e transportit rrugor dhe të jetë i aftë në futjen e procedurave të kontrollit dhe në veçanti ato që kanë lidhje me mjetin, drejtuesin e mjetit, mallrat dhe bagazhet që mbahen si në mjet, dhe në ndërtesat e ndërmarrjes;

Transporti rrugor i mallrave

4. të njihet me rregullat në organizimin e tregut në shërbimin e transportit rrugor të mallrave, në trajtimin e mallrave dhe logjistikën;

5. të njihet me formalitetet kufitare, rolin dhe qëllimin e dokumenteve T dhe karnetat TIR, dhe detyrimet dhe përgjegjësitë që burojnë prej përdorimit të tyre;

Transporti rrugor i udhëtarëve

6. të njihet me rregullat në organizimin e tregut në transportin rrugor të udhëtarëve;

7. të njihet me rregullat për futjen e shërbimeve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe të jetë i aftë të hartojë plane transporti.

G. Standardet teknike dhe aspektet e operimit

Transporti rrugor i mallrave dhe i udhëtarëve

Kandidati duhet, në veçanti:

1. të njihet me rregullat në lidhje me peshat dhe përmasat e lejuara të mjeteve rrugore dhe procedurat që ndiqen në rastin e ngarkesave jo normale, të cilat përbëjnë një përjashtim të këto rregulla;

2. të jetë i aftë të zgjedhë mjetet dhe komponentët e tyre (shasinë, motorin, sistemin e transmisionit, sistemin e frenimit, etj.) në përputhje me nevojat e ndërmarrjes;

3. të njihet me formalitetet lidhur me tipin e aprovuar, regjistrimin dhe kontrollin teknik të këtyre mjeteve;

4. të kuptojë çfarë masash duhet të ndërmerren për reduktimin e zhurmës dhe të luftojë ndotjen e ajrit nga emetimi i gazrave të automjeteve;

5. të jetë i aftë të hartojë plane mirëmbajtjeje periodike për mjetet dhe pajisjet e tyre;

Transporti rrugor i mallrave

6. të njihet me tipet e ndryshme të trajtimit të ngarkesave dhe pajisjet e ngarkimit (kontejnerë, paleta etj.) dhe të jetë i aftë të japë instruksione për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave (shpërndarjen e ngarkesës, grumbullimin, vendosjen, bllokimin dhe pengimin etj.);

7. të jetë i aftë të zbatojë procedurat në pajtim me rregullat mbi transportimin e mallrave dhe mbeturinave të rrezikshme sidomos ato që burojnë nga direktiva 94/55/EC, direktiva 96/35/EC;

8. të jetë i aftë të zbatojë procedurat në pajtim me rregullat e ushqimeve që prishen shpejt, sidomos ato që burojnë nga marrëveshja europiane mbi transportin ndërkombëtar të mallrave ushqimore delikate dhe pajisjet speciale që përdoren në të tilla transporte (ATP);

9. të jetë i aftë të zbatojë procedurat në pajtim me rregullat në transportin e kafshëve të gjalla.

H. Siguria rrugore

Transporti i rrugor i mallrave dhe udhëtarëve

Kandidati duhet, në veçanti:

1. të dijë çfarë kualifikimesh kërkohen për drejtuesit e mjeteve (leja e drejtimit, certifikata mjekësore, certifikata e përshtatshmërisë etj.);

2. të jetë i aftë të ndërmarrë hapat e nevojshëm për t'u siguruar që drejtuesit e mjeteve veprojnë në përputhje me rregullat e qarkullimit, ndalimeve dhe kufizimeve në fuqi në shtetet e ndryshme (kufizimi i shpejtësisë, përparësitë, kufizimet në pritje dhe parkime, përdorimi i dritave, sinjalet rrugore etj.);

3. të jetë i aftë t'u hartojë instruksione drejtuesve të mjeteve për kontrollin në zbatim me kërkesat e sigurisë, pajisjet dhe ngarkesat e tyre dhe në lidhje me masat parandaluese që ndërmerren;

4. të jetë i aftë të vendosë procedurat që ndiqen në rastin e aksidenteve dhe zbatimin e procedurave të përshtatshme për parandalimin ripërsëritjes të aksidenteve ose shkeljeve serioze në qarkullim;

Transporti rrugor i udhëtarëve

5. të ketë njohuri elementare të shpërndarjes së rrjetit rrugor europian.

Materiali bazë studimor:

- ligj nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar;

- ligj nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë";

- ligj nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";

- ligj nr.9723, datë 3.5.2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit";

- ligj nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare";

- ligj nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin 9125, datë 29.7.2003;

- ligj nr.8017, datë 25.10.1995 "Për procedurat e falimentimit";

- ligj nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", aktet në zbatim;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.325, datë 19.3.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës së personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor”;
- Konventa mbi kontratën për transportuesit ndërkombëtarë rrugorë të mallrave, CMR; protokoll i konventës;
- Konventa TIR dhe marrëveshjet bilaterale në transportin rrugor;
- Direktiva 94/55/EC, direktiva 96/35/EC (ose marrëveshja evropiane e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme, ADR);
- Marrëveshja europiane mbi transportin ndërkombëtar të mallrave ushqimore delikate dhe pajisjet speciale që përdoren në të tilla transporte (ATP);
- Konventa, që lidhet me punën e ekuipazheve në transportin ndërkombëtar rrugor, (AETR);
- Marrëveshja mbi transportin ndërkombëtar rrugor të rastit të udhëtarëve me autobus (marrëveshja Interbus).

Modeli A1
NR.2
Format A4 (294 x 210)
Pesha: 150 g/ m2
Ngjyra: e verdhë e fortë

SHTOJCA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

AL

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të
Transportit Rrugor

**CERTIFIKATA E KOMPETENCËS PROFESIONALE NË TRANSPORTIN RRUGOR
BRENDA VENDIT TË MALLRAVE/ UDHËTARËVE**

Nr. _____

Komisioni i vlerësimit të provimit, nëpërmjet kësaj, vërteton që:

(a)

Emri, mbiemri: _____
Vendi i lindjes: _____
Data e lindjes: _____

ka kaluar testet e provimit (viti:.....; kursi/ *) organizuar për

dhënien e certifikatës së kompetencës profesionale në transportin rrugor brenda vendit të mallrave/ udhëtarëve në përputhje me udhëzimin nr. __, datë ____ 2009 “Për certifikatën e kompetencës profesionale për drejtuesin e veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor”.

(b) personi i përmendur në (a) është kualifikuar për të punuar me aftësi profesionale në një ndërmarrje si drejtues veprimtarie për transportin rrugor të mallrave/ udhëtarëve:

duke u angazhuar vetëm në transportin brenda vendit,

Kjo certifikatë përbën provën e mjaftueshme të kompetencës profesionale për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave/ udhëtarëve në transportin kombëtar referuar VKM nr.325, datë 19.3.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”.

Lëshuar në....., më

Firma e kryetarit të komisionit

Firma dhe vula e DPSHTRr-së

* në rastin kur aplikohet sipas shkronjave “b”, “c” dhe “d” të nenit 7 të udhëzimit.

Modeli A2
NR.2

SHTOJCA

Format A4 (294 x 210)
Pesha: 150 g/m²
Ngjyra: e verdhë e fortë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

AL

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të
Transportit Rrugor

**CERTIFIKATA E KOMPETENCËS PROFESIONALE NË TRANSPORTIN RRUGOR
NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE/ UDHËTARËVE**

Nr. _____

Komisioni i vlerësimit të provimit, nëpërmjet kësaj, vërteton që:

(a)

Emri, mbiemri: _____

Vendi i lindjes: _____

Data e lindjes: _____

ka kaluar testet e provimit (viti:.....; kursi/ *:) organizuar për dhënien e certifikatës së kompetencës profesionale në transportin rrugor të brendshëm të mallrave/udhëtarëve në përputhje me udhëzimin nr.____, datë _____ 2009 “Për certifikatën e kompetencës profesionale për drejtuesin e veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor”.

(b) personi i përmendur në (a) është kualifikuar për të punuar me aftësi profesionale në një ndërmarrje si drejtues veprimtarie për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave/ udhëtarëve.

Kjo certifikatë përbën provën e mjaftueshme të kompetencës profesionale referuar VKM-së nr.325, datë 19.3.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”

Lëshuar në....., më

Firma e kryetarit të komisionit

Firma dhe vula e DPSHTRr-së

* në rastin kur aplikohet, sipas shkronjave “b”, “c” dhe “d” të nenit 7 të udhëzimit.